



Pranuar / Dorezuar Prilbjen/Prodato Received/Delivered	04.08.2023	3	viti god Year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAMSHICK	5549/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.875/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A nr 875/2023 të datës 22.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted], kundër organit të punësimit/Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.875/2023 e datës 22.06.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 02/60264/23 i datës 21.06.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit si dhe Renditja përfundimtare e kandidatëve për grupin Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorin e Pronës i datës 14.06.2023.
- III. Anullohet Vendimi me numër protokollit 02/60273/23 i datës 21.06.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit, konkursi me Nr.Reference: RN00011217 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme si dhe të gjitha veprimet që ndërlihen me të.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore

në Komunën e Gjilanit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke ndërmarr veprimet si në pikën III të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Gjilanit më datë 15.03.2023 ka njoftuar për shpalljen e tri konkurseve si: konkursin me Nr. Reference: RN00011142 për grupin Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorit i Kadastrit, konkursin me Nr. Reference RN00011143 për grupin Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorit i Pronës dhe konkursin me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

Në këto konkurse ka aplikuar edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak ndërsa është ftuar të marr pjesë në testin me shkrim, ku në bazë të rezultatit për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Kadastrit në testin me shkrim ka marr 49 pikë, për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Pronës ka marr 51 pikë ndërsa për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile në testin me shkrim ka marr 41 pikë. Në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit ankuesi nga numri i përgjithshëm i pikëve të testit me shkrim dhe vlerësimit të jetëshkrimit për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Kadastrit është vlerësuar me 59.6 pikë, për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Pronës është vlerësuar me 58 pikë ndërsa për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile është vlerësuar me 50 pikë, duke u njoftuar që nuk mund ti nënshtrohet intervistës me gojë për shkak që nuk ka arritur numrin prej 60 pikëve dhe në të njëjtën kohë i është dhënë udhëzimi juridik për ankesë prej 3 ditësh në Komisionin e Pranimit.

Ankuesi kundër vlerësimit të jetëshkrimit për të tri pozitat ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit. Komisioni i Pranimit më datë 21.06.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll 02/60264/23 që ndërlidhet me vlerësimin për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në Sektorin e Pronës duke e refuzuar ankesën e ankuesit dhe duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 16.06.2023, ndërsa për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile", Komisioni i Pranimit përmes Vendimit me numër protokoll 02/60273/23 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 16.06.2023.

Ndërsa për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Kadastrit, fillimisht ankuesi është vlerësuar tek jetëshkrimi me 8.6 pikë ndërsa pas rivlerësimit është bërë ndryshmi i pikëve si dhe në bazë të emailit të datës 06.07.2023 ankuesi është njoftuar se ka marr pikët e nevojshme për intervistë me gojë duke u ftuar më datë 07.07.2023 për intervistë.

Ankuesi, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 22.06.2023 ka parashtruar

ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.875/2023 me numër protokoli 4872/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.06.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjilanit. Ndërsa, Këshilli më datë 07.07.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 4872/2023 të datës 22.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me Nr. Reference: RN00011142 për grupin Specialit Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorit i Kadastrit; Konkursin me Nr. Reference RN00011143 për grupin Specialistë Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorit i Pronës; Konkursin me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialit i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme; Njoftimin për rivlerësimin e jetëshkrimit i datës 21.06.2023 për tri pozitat; Njoftimin për rezultatet e vlerësimit i datës 16.06.2023 për të tri pozitat; Njoftimin për ankuesin për tri pozitat i datës 08.06.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 07.07.2023; Vendimin me Nr. 02/476 i datës 12.03.2023 për themelimin e komisionit për pranim; Listën e aplikacioneve për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Pronës; Listën e rezultateve përfundimtare të verifikimit paraprak për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Pronës; Emailin e datës 11.05.2023 nga F.H për ankuesin lidhur me orarin e testit me shkrim për tri pozitat; Formularin e vlerësimit për CV; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatët për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Pronës i datës 14.06.2023; Vendimin me numër protokoli 02/60264/23 të datës 21.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit; Aplikacionin e ankuesit i datës 05.04.2023; Diplomë me Nr. 76 e ankuesit; Diplomën me Nr. 21 e ankuesit; Vërtetimin e datës 29.10.2019 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan; Njoftimin e datës 14.02.2019; Referencë nga ankuesi; Dokument identifikimi i ankuesit; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan e datës 17.11.2022; Listën e aplikantëve për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Kadastrit; Rezultatet përfundimtare të verifikimit paraprak për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Kadastrit; Emailin e datës 06.07.2023 nga F.H për ankuesin; Emailin e datës 07.07.2023 nga F.H për ankuesin për intervistë; Rendoqjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën Zyrtar Ligjor në Sektorin e Kadastrit e datës 07.07.2023; Njoftimin e datës 07.07.2023 për ankuesin; Lista e aplikantëve për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile; Rezultatet përfundimtare të Verifikimit paraprak për Zyrtar të Gjendjes Civile; Rënditjen përfundimtare për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile e datës 14.06.2023; Vendimin me numër protokoli 02/60273/23 të datës 21.06.2023 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Gjilanit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstaton se pretendimet e ankuesit ndaj konkursit me Nr.

Reference RN00011143 për grupin Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Spektori i Pronës, janë të pabazuara, sepse:

Nga provat e lëndës, respektivisht në bazë të konkursit me Nr. Reference RN00011143 për grupin Specialist Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Spektori i Pronës si kërkesa të përgjithshme formale janë paraparë: *"Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione Deficitar TIK; Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së listë të punës"*.

Nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore që ndërlidhen me këtë pozitë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi në bazë të provave të lëndës është përfshirë në listën e verifikimit paraprak, ndërsa është ftuar të marr pjesë në testimin me shkrim ku pas kësaj fazë ka marr gjithsej 49 pikë në testin me shkrim, ndërsa pas kësaj faze është bërë vlerësimi i jetëshkrimit kur rezulton se sipas formularit të vlerësimit të jetëshkrimit ankuesi është vlerësuar me nëntë (9) pikë. Rrjedhimisht në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit ankuesi është vlerësuar për nivelin e arsimit dhe përvojës së punës ndërsa për trajnimet i njëjti është vlerësuar me zero (0) pikë për shkak që në aplikacionin e tij nuk ka bashkangjitur ndonjë certifikatë trajnimi.

Sa i përket vlerësimit të jetëshkrimit, respektivisht nivelit të arsimit i njëjti është vlerësuar me gjithsej shtatë (7) pikë, ngase në këtë pjesë kandidati vlerësohet për nivelin e arsimit dhe cilësinë e arsimit, ku për nivelin e arsimit ka marr tetë (8) pikë ndërsa për cilësi ka marr gjashtë (6) pikë që në përpjesëtim me dy (2) ka rezultuar me shtatë (7) pikë në këtë pjesë, ndërsa sa i përket përvojës së punës është vlerësuar me dy (2) pikë, që në këtë fazë është vlerësuar me gjithsej nëntë (9) pikë, kështu që sipas provave të lëndës, ankuesi nuk ka arritur të grumbulloj pikët e nevojshme për t'iu nënshtruar intervistës me gojë, ngase sipas nenit 34 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *"10. Kandidatët të cilët nuk i fitojnë 60% të pikëve nuk ftohen në intervistën me gojë"* dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Pas vlerësimit të jetëshkrimit, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë në dy hapat e para të vlerësimit, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë"*. Bazuar në dispozita ligjore në fuqi konkretisht sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 34 paragrafi 1, 2, 6, 7, 8, 9 dhe 10 të këtij ligji, dhe depozitave të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht nenit 14, 15, 16, 21, 22, 23 dhe 25, kështu që procedura e pranimit për grupin Specialistë Ligjor për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Spektori i Pronës është bërë në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj kësaj procedura janë të pabazuara.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër protokolli 02/60264/23 i datës 21.06.2023 i Komisionit të Pranimi të Komunës së Gjilanit, është nxjerr në pajtim me nenin 25 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe i arsyetuar në pajtim e dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës sa i përket pretendimeve të ankuesit ndaj konkursit me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, konstaton se këto pretendimet janë të **bazuara sepse**:

Në bazë të konkursit me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, të shpallur me datë 15.03.2023 nga Komuna e Gjilanit, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: *"Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione Deficitar TIK; Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti Juridik, administratë publike; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së listë të punës"*, ndërsa sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është bërë kategorizimi i pozitave në shërbimin civil siç parashihet me nenin 33 paragrafi 2, i cili përcakton se: *"2. Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*, atëherë Kolegji i Këshillit, në vështrim të nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me pozitat e kategorisë profesionale është përcaktuar se: *"1. Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1 Profesional 2 Profesional 3"*, rrjedhimisht meqenëse pozita e shpallur nga Komuna e Gjilanit është e kategorisë profesionale klasa profesionale 3, atëherë sipas shtojcës Nr. 1/8 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për klasën Profesional 3, konkretisht kërkesat e përgjithshme formale janë përcaktuar: *"a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet"*, ndërsa sipas Shtojcës me Nr. 2 lidhur me grupet tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm për grupin Specialist i administrimit të përgjithshëm është përcaktuar *Arsim i lartë i paspecifikuar*. Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, tek kualifikimet e posaçme formale janë përshkruar kualifikimet e arsimit të kërkuar, ndërsa sipas legjislacionit në fuqi që rregullon këtë çështje tek kualifikimet e posaçme formale duhet të përshkruhen certifikatat, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase e jo në këtë pjesë të përshkruhen kriteret e arsimit. Rrjedhimisht Kolegji

i Këshillit konstaton se për grupin Specialist i administrimit të përgjithshëm është përcaktuar arsimim i lartë i paspecifikuar, ndërsa Komuna e Gjilanit ka bërë kufizimin e arsimit të kërkuar, kështu që konkursi i shpallur është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Bazuar në këtë që u tha si më lartë Kolegji i Këshillit, konstaton faktin se konkursi me Nr. Reference: RN00011217 për grupin Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile 1", dy pozita, në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, që nga fillimi i shpalljes është përcjellë me shkeljet procedurale të theksuara si më lartë dhe mbi këtë bazë me vendosjen e kriterëve përtej atyre që janë paraparë me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil konstatohet fakti që i është mohuar e drejta për aplikim kandidatëve të tjerë që nuk kanë kualifikime në drejtimin juridik apo administratë publike, si rezultat i kësaj, Kolegji i Këshillit thekson faktin se kjo procedurë është në kundërshtim me dispozitat e potencuara si më lartë.

Kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër protokolli 02/60273/23 i datës 21.06.2023 i Komisionit të Pranimi të Komunës së Gjilanit është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi e i cili nuk ka pasqyruar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, rrjedhimisht është nxjerr edhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimet e ankuesit që ndërlidhen me konkursin me Nr.Reference: RN00011142 për grupin Specialist Ligjor për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorit i Kadastrit, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave materiale të lëndës, Komisioni i Pranimi ka bërë rivlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit dhe në bazë të rezultatit ka rezultuar se ankuesi ka marr pikët e nevojshme për t'u ftuar në intervistë me gojë, kështu që më datë 06.07.2023 ankuesi është njoftuar se ka kaluar këtë fazë dhe është ftuar në intervistë me gojë më datë 07.07.2023, kurse sipas renditjes përfundimtare të kandidateve për këtë pozitë të datës 07.07.2023 ka marr 68 pikë gjithsej nga të gjitha fazat e procedurës. Kështu që meqë kjo procedure ka përfunduar sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 07.07.2023 atëherë ankuesit i lind e drejta për ndjekjen e procedurave të ankimit ndaj përfundimit të procedurës, në kuptim të nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet"*, kështu që në këtë fazë Kolegji nuk mund të shqyrtoj në mënyrë meritore pretendimin e ankuesit që ndërlidhet me konkursin me Nr. Reference: RN00011142 për grupin Specialist Ligjor për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë/Sektorit i Kadastrit.

Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë çështjen që është objekt i kësaj anekese dhe dispozitivin e këtij vendimi,

konstaton se Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit janë të obliguar që në kuptim të pikës **III** të dispozitivit të këtij vendimi të ndërmarrin veprimet e nevojshme juridike.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.875/2023, datë 04/08/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.